




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurençiju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 579/24 - 1210  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/2  
Data/I Date/Date: 09.09.2024

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurençiju - Competition Authority



Vendimi nr. 79/24

Prishtinë, më 09.09.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, parografi 1.8 dhe 1.11, neni 32, neni 55 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datën 09.09.2024 jep këtë:

### REKOMANDIM

- I. Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056, për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 32, Autoriteti mund të japë rekomandim ose të publikojë kumtesë, për të informuar dhe për të ndërgjegjësuar publikun për konkurrencën në treg, duke përfshirë legjislacionin, politikat dhe zhvillimet krahasuese, të cilat kanë të bëjnë me avokimin dhe rritjen e kulturës së konkurrencës. Avokimi në konkurrencë, duhet të ketë një rol të rëndësishëm, në mënyrë që politika e konkurrencës të zbatohet me sukses, si dhe promovimin e një mjedisi konkurrues për aktivitetet ekonomike.
- II. Parimi themelor i ligjit, politikës së konkurrencës dhe misioni i AKRK-së është të nxitë dhe sigurojë qasje në treg të lirë, për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg, në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmime e cilësi me ndërmarrjet e tjera, në kushte të barabarta me qëllim të krijimit të një tregu konkurrues, në të cilin konsumatori do të zgjedhë atë produkt apo shërbim për të cilin ka preferenca për të përbushur nevojat apo dëshirat e tij.
- III. Institucionet duhet të janë në mbrojtje të interesit publik, gjithashtu duhet të kujdesen që të krijojnë ambient të përshtatshëm për operatorët aktual dhe nxitës për konkurrencën e mirëfilltë, në të cilën Komuna në këtë rast do ta monitoronte mbarëvajtjen e licencimit për ta parandaluar tjetërsimin e lejeve në transport publik apo edhe marrëveshjet për fiksime të çmimeve, të cilat në rrethana të caktuara nuk kanë asnjë predispozitë të ndodhin.
- IV. Ndërveprimi midis politikave të konkurrencës dhe Ligji mbi vetëqeverisjen lokale është më se i nevojshëm. Ato prekin njëra-tjetër për nevojën për të trajtuar praktikat anti konkurruese ose mënjanuar marrëveshjet e ndaluara, në formë të praktikave të bashkërenduara apo fiksimit të çmimeve siç mund të janë në rastin e transportit publik

1

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr. 1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

ndërurban, ku Komuna e Gjilanit në këtë rast, e luan rolin e mbikëqyrësit në tregun përkatës.

- V. Autoriteti i Konkurrencës në bazë të analizës ligjore, vlerëson se institucioni kompetent për zgjidhjen e këtij rasti është organi publik, i cili edhe i lëshon lejet e udhëtimit apo licencat, brenda hapësirës së veprimit që ofron Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor. Me dispozitat e këtij ligji, rregullohet kjo çështje pa qenë e nevojshme që të fillohet me procedurat hetimore nga Autoriteti i Konkurrencës, për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese për marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar nga ndërmarrjet në fjalë në zonën e caktuar gjeografike për tregun relevant.
- VI. Autoriteti i Konkurrencës i rekomandon Komunës së Gjilanit, ta monitoroje tregun ku palët pretendojnë të kenë realizuar transaksion ekonomik në para kesh, Autoriteti i Konkurrencës si institucion i pavarur, referuar të dhënavë zyrtare që ndërmarrjet i kanë në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, nuk e ka faktuar një ndërrim të pronësisë apo shtim të ndonjërit nga aksionarët e rindërimit. Autoriteti e konsideron që në këtë fazë, mund të jetë më kompetente Komuna e Gjilanit për ta vërtetuar tjetërsimin e linjave apo edhe ndryshimet e tjera, që potencialisht mund të bien ndesh me Ligjin e transportit rrugor apo çdo akt tjetër normativ, që komuna e Gjilanit e konsideron të arsyeshme për ta konsultuar.

#### AUTORITETI I KONKURRENCËS



Kaltrina Sela

Nënkyetare

Florent Mehmeti

Anëtar

Nafije Osdautaj

Anëtar

Salihe Gashi Loku

Anëtar

Me këtë Rekomandim të njoftohen:

- *Paraqitësit e iniciativës*
- *Komuna e Gjilanit*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Arkiva*